

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM



Nr. **1471** prot

Jorgucat më **18.10.2023**

Shkresë

Për miratimin e planit vjetor të auditimit 2024 dhe planit strategjik 2024-2026.

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 28/1, Ligjit Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", neni 14/c, si dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm (Kap.III).

Miratoj:

- I. Planin vjetor 2024 të auditimit të brendshëm dhe planin strategjik 2024-2026, të hartuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, sipas materialit bashkëngjitur:
1. Relacion përmbledhës, lidhur me hartimin e planit vjetor të auditimit 2024 dhe planit strategjik 2024-2026.
2. Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektin (pasqyra 1)
3. Planin Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar nga NJAB nga viti 2024-2026 (pasqyra 2)
4. Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2024 (pasqyra 3)
5. Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të stafit të NJAB për vitin 2024 (pasqyra 4)
6. Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2024 (pasqyra 5)

Kryetari i Bashkisë

Dhimitraq TOLI

Konc.Daktilografoi
Drejtuesi i Njesise se Auditimit
Stefan Kafulli



Relacion mbi hartimin e planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 dhe planit strategjik 2024-2026

Në mbështetje të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 14, pika “c” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhërin nr.100, të Ministrit të Financave, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Planifikimi i Veprimtarisë të Auditimit të Brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull ka programuar planin e veprimtarisë së auditimit për vitin 2024 dhe planin strategjik për vitet 2024-2026.

Për hartimin e këtyre dy dokumentave të rëndësishëm të veprimtarisë së AB, ka marrë në konsideratë kërkesat e menaxhimit të lartë (Kryetareve të Bashkive Dropull, Libohove dhe Finiq), auditimet e kryera gjatë viteve, përvojën e kësaj strukture në këtë shërbim, aftësitë profesionale të audituesve të punësuar, pozicionin gjeografik dhe shtrirjen territoriale të institucionit, ndikimin e ndryshimeve të legjislacionit në fusha të ndryshme të funksionimit dhe shërbimeve që afrojnë keto Bashki.

Ky planifikim është fokusuar në vlerësimin e mjedisit të kontrollit të çdo subjekti të përfshirë në planifikim, vlerësimin të nivelit të riskut në sisteme të ndryshme, si edhe duke marrë në konsideratë vlerësimet e viteve të mëparshme, të çdo subjekti, me qëllim përfshirjen dhe parashikimin në planifikimin strategjik të tyre në planifikimin për tu audituar nga NJAB.

Në përmbushjen e objektivave të parashikuara, në planifikimin e auditimeve të Njesise së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dropull, Bashkinë Libohove dhe në Bashkinë Finiq paraqesim:

- Organizimin dhe kryerjen e misionëve të auditimit pranë subjekteve të miratuara në planin strategjik dhe planin vjetor.
- Kryerjen e auditimeve me objektivitet, paanshmeri, profesionalizem dhe me efektshmeri.
- Kryerjen e Investigimit pranë subjektit të audituar, përcaktimi i materialitetit, identifikimi dhe vlerësimi i riskut.
- Sigurimi i cilesise se auditimit, nepermjet procesit te vazhdueshem te mbikqyrjes.
- Zhvillimi i burimeve njerezore, trajnimi i stafit dhe motivimi i tyre.

Nëpërmjet identifikimit të fushave të llogarisë që ekzistojnë në këto subjekte është bërë i mundur parashikimi dhe vlerësimi i nivelit të riskut duke i dhënë përparësi atyre fushave apo sistemeve të cilat paraqesin risk të lartë dhe të mesëm.

Gjithashtu u bë parashikimi fushave më kritike të cilat kërkojnë vëmendjen e auditimeve. Nëpërmjet identifikimit të sistemeve dhe përcaktimit të nivelit të riskut është ruajtur frekuencë e tillë që të mundësojë përfshirjen e të gjitha sistemeve dhe fushave që kërkojnë frekuencë më të shpeshtë të auditimit.

Përsa i përket strukturës të AB pranë Bashkisë Dropull, Njesi Auditimi e cila auditon dhe Bashkinë Libohove sipas Akt Mareveshjes (te rinovuar) firmosur nga Ministri i Financave dhe Ekonomise me shkresen nr. 8447 date 12.05.2021, si dhe Bashkinë Finiq sipas Akt Mareveshjes (te rinovuar) firmosur nga Ministri i Financave me shkresen nr 17390/1 date 05.11.2021, krahas planifikimit të vetë njësive shpenzuese kryen auditim dhe tek strukturat në varësi të tyre, ku planifikimi i auditimeve është bërë sipas përcaktimeve në ligjin „Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, e perkatesisht:

Në Bashkinë Dropull ka tre Njesi Administrative:

- Njësia Administrative Dropull i Poshtem.
- Njësia Administrative Dropull i Siperem.
- Njësia Administrative Pogon.

Në Bashkinë Libohove ka dy Njesi Administrative:

- Njësia Administrative Qender Libohove.
- Njësia Administrative Zagorie.

Ne Bashkine Finiq ka pese Njesi Administrative:

- Njesia Administrative Livadhja.
- Njesia Administrative Dhiver.
- Njesia Administrative Aliko.
- Njesia Administrative Finiq.
- Njesia Administrative Mesopotam.

Qëllimi i Planit Strategjik dhe Misioni i NJAB

Qëllimi i Planit Strategjik

Planit strategjik 2024 – 2026 “Per veprimtarine e Auditimit te Brendshem ne Bashkine Dropull”, e cila mbulon me kete sherbim dhe Bashkite Libohove dhe Finiq, si pjesë e rëndësishme e procesit të auditimit, ka si qellim identifikimin e fushave te veprimit te struktures se auditimit te brendshem, per periudhen 3 vjecare.

Ai bazohet ne analizen e risqeve, te programeve dhe veprimtarive te identifikuara per auditim, duke marre dhe ne konsiderate informacione nga menaxhimi i larte, mbi bazen e te cilave percakton mbulimin/ frekuencen e auditimit sipas subjekteve qe programohen per çdo audit, duke siguruar që të gjitha sistemet/fushat me risk te mbulohen gjatë kësaj periudhe.

Qëllimi dhe misioni i auditimit te brendshem, konsiston:

- Ne ndihmen e dhene menaxhimit duke ofruar analiza, rekomandime, keshillime dhe informacione lidhur me veprimtarine qe ai ka te vleresuar.
- Ne dhenien ne menyre te pavarur te nje sigurie te arsyeshme objektive tek titullari i subjektit, mbi saktesine dhe besueshmerine e raporteve financiare dhe performances, te pregatitura nga strukturat e menaxhimit, per te shtuar vleren dhe permiresuar operacionet e veprimit te subjektit.
- Ne egzaminimin dhe vleresimin e mjaftueshmerise dhe efektivitetin e sistemit te kontrollit te brendshem, tek sistemet e menaxhimit financiar, si sistemi i buxhetit, si sistemi i kontabilitetit, i rekrutimit te punonjesve dhe i pagesave, i të ardhurave, i prokurimeve, vleresimi i detyrimeve te prapambetura, apo dhe zbatimi i rekomandimeve te lena ne auditimet e meparshme.
- Ne vleresimin e pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem ne strukturat qe menaxhojne fondet IPA.

Misioni i NJAB

Auditimi i brendshem ne ushrimin e veprimtarise se tij te pavarur dhe objektiv synon te ndihmoje subjektet e audituara ne Bashkite Dropull, Libohove dhe Finiq, qe te permbushin objektivat e tyre.

Ai ben vleresime, jep opinione dhe rekomandime objektive, per:

- Identifikimin, vleresimin dhe menaxhimin e riskut.
 - Funksionimin e elementeve te kontrollit te brendshem(ambjentin e kontrollit, menaxhimin e riskut, informimi, komunikimi apo dhe monitorimi).
 - Besueshmerine dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional.
 - Te siguruar titullarin e subjektit te audituar se fondet publike jane perdorur me ekonomi, efikasitet, efçence, sipas planifikimit dhe qëllimit te miratimit te fondeve.
- Misioni i NJA, është qe të japë siguri të arsyeshme për Titullarin e Bashkise, duke ofruar analiza, rekomandime, keshilla dhe informacion lidhur me veprimtarite qe ka vleresuar.

Organizimi i NJAB dhe Kuadri ligjor

Organizimi i NJAB

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Bashki Dropull, funksionon si drejtori. Sipas vendimit të keshillit bashkiak, struktura është miratuar me 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori, si dhe me 3 audite, por në fakt të punësuar janë 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori dhe 1 audit. Njesia e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, është njësi e cila jep shërbim dhe në Bashkinë Libohovë me Akt Mareveshjen firmosur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.8447, datë 12.05.2021, si dhe Bashkinë Finiq sipas Akt Mareveshjes firmosur nga Ministri i Financave me shkresën nr 17390/1 datë 05.11.2021.

Kuadri Ligjor në të cilin është mbështetur veprimtaria e auditimit të brendshëm.

Programimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2024 dhe planifikimi strategjik për vitin 2024-2026 është bërë duke u mbështetur në standartet e auditimit të brendshëm në sektorin publik, të shprehura qartë në Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, (të ndryshuar) Kodit Etik, si dhe Ligji nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Objektivat strategjike

Njesia e auditimit të brendshëm, në planifikimin e misioneve të auditimit është mbështetur në dispozitat ligjore (aktet ligjore dhe nënligjore) që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe ka synuar që nëpërmjet misioneve të planifikuara dhe realizimit të tyre të bëjë vlerësimin në thellësi të sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit të brendshëm, me qëllim që të përcaktojë se ato në veprime me kosto efektive, në mënyrë efikase dhe efektive për arritjen e objektivave dhe që janë gjendje të identifikojnë mangësitë dhe të ndërmarrin veprime korrigjuese.

Në këtë kuadër objektivat strategjike janë vendosur në mënyrë të tillë dhe në funksion të qëllimit dhe misionit të AB, ku nëpërmjet auditimeve të planifikuara për t’u realizuar është synuar që t’u japë siguri të arsyeshme kryetareve të Bashkive, për:

- Rritja e cilësive dhe e performancës së auditimeve me shtimin e numrit të cilësive të zbulimeve si dhe impakti në rritje përse i përket përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit të vlerës.

- Menaxhim efektiv i burimeve të auditimit, bazuar në aftësitë profesionale.

- Bashkëpunim cilësor dhe profesional me organizatat e audituara, për hartimin dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të auditëve, përmes trajnimeve në fushën e procedurave dhe metodave/technikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut.

- Ofron shërbime keshillimi për titullaret e Bashkive, për t’i ndihmuar ata në marrjen e vendimeve të duhura dhe me synim shtimin e vlerës, nëpërmjet vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Jep opinion të pavarur mbi veprimtaritë e audituara dhe identifikon nëse ato janë zhvilluar në përputhje dhe në pajtim me ligjin dhe rregullat në fuqi dhe nëse drejtimi ka ndërtuar një sistem efikas të kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit.

Identifikimi i subjekteve

Në planifikimin strategjik dhe atë vjetor, nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është synuar të përfshihen të gjitha subjektet. Kështu referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, si subjekt i auditimit të brendshëm janë identifikuar Bashkia Dropull, Bashkia Libohovë, Bashkia Finiq, si dhe Njësitë administrative respektive, ku duhet të auditohen brenda periudhës 3-vjeçare, dhe si të tilla duhet të përfshihen në këtë pjesë të Planit Strategjik.

Kjo do të thotë që asnjë subjekt nuk duhet të mbetet jashtë kësaj liste pavarësisht periudhës së kur auditohet.

Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare

Nga analiza e bërë situatës aktuale, veprimtarisë së Bashkise Dropull, Bashkise Libohove, Bashkise Finiq, si dhe Njesive Administrative, problematikave të evidentuara nga auditimet të kryera nga institucionet përkatëse në kompetencë të kuadrit ligjor për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe vlerësimit të riskut të përgjithshëm të subjekteve të evidentuara për auditim, janë programuar edhe angazhimet e auditimit në nivel strategjik dhe vjetor.

Kështu janë evidentuar si fusha dhe sisteme prioritare:

- Sistemi i prokurimeve publike.
- Sistemi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.
- Sisteme të rekrutimit (të burimeve njerëzore).
- Sistemi i pagesave.
- Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.
- Fusha e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- Fusha e administrimit dhe mbrojtjes së tokës bujqësore.
- Vlerësimi i situatës të detyrimeve të prapambetura.
- Vlerësimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lena në auditimet e mëparshme.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm të fondeve IPA.
- Fusha e funksionimit të strukturave të reja, të cilat në kuadër të zbatimit të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", siç janë ato të arsimit parauniversitar, pyjet dhe kullotat, etj.

Sistemet dhe fushat e evidentuara si prioritare i përkasin Bashkisë Dropull, Bashkise Libohove dhe Bashkise Finiq, duke përfshirë këtu të dhjetë njësitë administrative, pjesë përbërëse të këtyre Bashkive. (Njësia administrative Dropull i Poshtëm, Njësia administrative Dropull i Sipërm, Njësia administrative Pogon, Njësia Administrative Qender Libohove, Njësia Administrative Zagorie, Njësia Administrative Livadhja, Njësia Administrative Dhiver, Njësia Administrative Aliko, Njësia Administrative Finiq dhe Njësia Administrative Mesopotam).

Planifikimi strategjik dhe vjetor është bërë pas identifikimit të fushave apo sistemeve më me risk, duke identifikuar më qartë angazhimet e auditimit.

Pra subjekte për tu audituar do të jenë 3 në total (Bashkia Dropull, Bashkia Libohove, si dhe Bashkia Finiq), por për secilin prej tyre është bërë ndarja sipas fushave për auditimet që janë planifikuar të kryhen gjatë 3 viteve.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për vitin e parë janë parashikuar subjektet dhe fushat e vlerësuara me risk të lartë apo dhe të mesëm. Në vitin e dytë dhe të tretë janë parashikuar të auditohen subjektet dhe vlerësuara me risk të lartë dhe të mesëm duke respektuar dhe kohen për auditim, sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve është bërë duke marrë në konsideratë disa faktorë, kryesisht:

- Pikëpamjet dhe shqetësimet e menaxhimit të lartë (kryetareve të bashkive).
- Ndikimet e jashtme në veprimtarinë e njësisë vendore dhe kryesisht lidhur me ndryshimet e legjislacionit në fushat e ndryshme të ushtrimit të veprimtarisë së përditshme të njësive vendore.
- Ndikimet e brendshme që lidhen me rekrutimet e burimeve njerëzore, nivelit arsimor dhe profesional të stafit të rekrutuar.
- Problematikat e evidentuara nga auditimet e brendshme dhe të jashtme.

Plani strategjik është fokusuar në balancimin e faktorëve përmendur më sipër, me qëllim realizimin e objektivave prioritarë të institucionit dhe të vetë veprimtarisë së AB.

Kufizimet e Auditimit

Pavarësisht se NJAB ka përgatitur planin strategjik dhe atë vjetor, egzistojnë faktorë potencialë të cilët mund të kenë ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të NJAB, si:

- Mungesa e bashkepunimit reciprok dhe përgjegjshmeria e subjekteve që auditohen.
- Mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve nga vete subjektet që auditohen.
- Mungesa e veprimtarisë të kontrollit të brendshëm të vendosura nga vete subjektet që auditohen.
- Mungesa e numrit të plote të audituesve sipas struktura të miratuar, ku nga 5 auditues sot janë të punësuar vetëm 3 auditues.

Ndikim në mos realizimin e objektivave të trajtuara sa më sipër mund të jetë dhe ndonjë faktor tjetër i pa parashikuar.

Prioritet për tre vitet

Prioritetet për periudhën tre vjeçare janë fokusuar:

- Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve, për sigurimin e cilësisë së auditimit.
- Në sigurimin e një mbikqyrje vjetore duke ruajtur frekuencat e auditimit dhe vlerësimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm, dhe zonat që kërkojnë një vëmendje të veçantë.
- Në analizën e kontrollit të riskut, si dhe riskut të gabimeve në deklaratat financiare.
- Planifikimin e misionëve të auditimit në mënyrë të integruar, ku çdo sistem, konsiderohet si pjesë e një auditimi me bazë sistemi (pra janë parashikuar të gjithë sistemet e një veprimtarie të çdo subjekti).
- Vendosjen e komunikimeve me auditimin e jashtëm (KLSH), me synimin për të ndjekur rekomandimet e tyre dhe shmangien e dublimeve të mundshme.
- Vendosjen e një raportimi efektiv për zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve.

PLANI VJETOR

Zhvillimet aktuale të NJAB

Kjo strukturë është organizuar në nivel Drejtori me pesë punonjës, por në fakt sot funksionon me tre auditues, njëri prej të cilëve është drejtues i njësisë.

Në planifikimin e angazhimeve të auditimit për vitin 2024 dhe planin strategjik 2024-2026, janë marrë në konsideratë funksionimi i Njesive Administrative në drejtim të menaxhimit të shërbimeve publike, vlerësimin e menaxhimit të fondeve publike, vlerësimin e sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, si dhe në vlerësimin e detyrimeve të prapambetura që janë krijuar pranë ketyre njesive.

Drejtimet sa më sipër kanë patur ndikim mbi programimin e numrit të angazhimeve me qëllim vlerësimin e funksionimit të tyre, në drejtim të:

- Evidentimi dhe zgjidhja e problemeve të komunitetit për çdo kërkesë, ankesë apo çdo kontakt që ka me administratën e njësisë.
- Si është kryer evidentimi dhe zgjidhja e nevojave publike që ka komuniteti në drejtim të shërbimit të pastrimit, ndricimit publik, mirëmbajtje të ndryshme, etj.
- Si janë menaxhuar fondet si në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, vlerësimi i prokurimeve të kryera, etj.
- Si janë menaxhuar burimet njerezore.
- Evidentimi dhe përcaktimi i arsyes së krijimit të detyrimeve të pa likujduara.
- A janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna dhe zbatimi i tyre.
- Vlerësimi i menaxhimit të fondeve IPA.

Prioritetet e auditimit për vitin 2024

Prioritetet e auditimit për vitin 2024 janë mbështetur dhe fokusuar në evidentimin e sistemeve dhe fushave me risk të lartë dhe të mesëm, ku janë si më poshtë:

- Vlerësimi i sistemit të prokurimeve publike.

- Vlerësimi i sistemit të kontrollit dhe menaxhimit financiar.
- Vlerësimi i sistemeve të rekrutimit të burimeve njerëzore.
- Vlerësimi i funksionimit të njesise së shërbimeve.
- Vlerësimi i funksionimit të Njesive Administrative.
- Vlerësimi i situates mbi detyrimet e prapambetura.
- Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve, të lena në aktet e mëparshme.
- Vlerësimi i menaxhimit të fondeve IPA.

Objektivat kryesore për vitin 2024

Në përputhje me objektivat strategjike të veprimtarisë së AB, standartet e AB, si edhe objektivat e institucionit, NJAB ka përcaktuar objektivin e saj për vitin 2024, duke u fokusur në dhënien e sigurisë së arsyeshme titullarit të institucionit për nivelin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë së pavarur dhe objektivave të strukturës së AB.

Programimi i llojit të angazhimeve

Për planifikimin vjetor 2024, është marrë në konsideratë përfshirja e subjekteve të identifikuar për auditim dhe në total janë parashikuar 11 angazhime auditimi me bazë sistemi, të 11 auditimet janë perputhshmerie.

Numri i subjekteve të identifikuar që duhet të auditohen është 3, e konkretisht:

- Bashkia Dropull, Bashkia Libohovë, si dhe Bashkia Finiq.
- Numri i subjekteve të identifikuar në perspektivë mendojmë se do të këtë ndryshim, për shkak të zgjerimit të kompetencave të njësive vendore dhe rritjes së rolit të pushtetit vendor në kuadër të autonomisë vendore dhe rritjes së decentralizimit të tij.

Të 11 angazhimet e perputhshmerise të planifikuara janë:

- “Vlerësimi i situates mbi detyrimet e prapambetura”, në të tre bashkitë.
- “Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të lena në aktet e mëparshme”, në të tre bashkitë.
- Vlerësimi i funksionimit të sistemit në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, menaxhimit të burimeve njerëzore, shërbimit urban dhe shërbimeve publike, si dhe funksionimi i Njesive Administrative, në të tre bashkitë.
- Vlerësimi i funksionimit të menaxhimit të fondeve IPA, në bashkinë Dropull dhe Finiq.

Planifikimi i kostos për vitin 2024

Planifikimi i kostos vjetore 2024, është bërë mbështetur në burimet në dispozicion. Duke qenë se struktura e AB, pranë Bashkisë Dropull për vitin 2024 funksionon me 3 auditues edhe planifikimi i kostos është bërë mbështetur në kërkesën për fonde për paga e sigurime shoqërore, për udhëtim e dieta dhe të tjerë tregues pasqyruar në Pasqyrën nr. 5 të planifikimit.

Planifikimi i burimeve për vitin 2024

Referuar Pasqyrës nr. 5 dhe të dhënave aktuale të strukturës së AB janë planifikuar burimet për vitin 2024, duke përcaktuar shpërndarjen e burimeve njerëzore të NJAB, të tillë si: koha maksimale e vlefshme, pushimet vjetore, festa zyrtare, pushime për arsye shëndetësore, angazhime në trajnime dhe angazhime në mbledhje/takime.

Në total koha maksimale e vlefshme në dispozicion për çdo auditues është 260 dite, nga të cilat 192 janë ditë efektive në dispozicion. Ditët e tjera përbëjnë ditët të cilat i nevojiten një audituesi për pushimet vjetore, pushime për arsye shëndetësore, festa, trajnime, apo takime dhe mbledhje të ndryshme gjatë vitit.

Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Në planifikimin e nevojave për trajnim të stafit të AB, janë marrë në konsideratë nevojat aktuale për trajnim dhe periudha më e përshtatshme (pa ngarkesë me angazhime auditimi) për

të qenë prezent në trajnimet e ofruara nga Struktura përgjegjëse për AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe kryesisht ato janë të fokusuara në këto drejtime:

- Auditim i performances, në drejtim të planifikimit, metodologjise që duhet përdorur për auditimin e Performances, si dhe kryerja e këtij lloji auditimi.
- Në drejtim të menaxhimit të Riskut, metodat, teknikat dhe hapat konkrete të ndjekura në praktike për identifikimin, vlerësimin, monitorimin, raportimin dhe menaxhimin e risqeve.
- Në drejtim të vlerësimit të pershtatshmerisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm të fondeve IPA.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Sa i takon sigurimit të brendshëm të cilësisë, duam të sjellim në vëmendje se duke qenë se kjo strukturë funksionon për momentin me tre auditues të çertifikuar, organizimi i grupit të auditimit do realizohet me pjesmarjen e gjithë stafit, kjo për të arritur cilesine e auditimeve dhe arritjen e realizimit të objektivave kryesore të NJAB si më poshtë:

- Të realizojë veprimtarine audituese të orientuar nga vlerësimi i riskut dhe në shërbim të menaxhimit.
- Përmirësimi i sistemit të programimit dhe metodologjise së vlerësimit të riskut sipas sistemeve, me qëllim garantimin e një efijënsie sa më të lartë në përputhje me fushën për auditim.
- Rritja e cilesise së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve duke patur impakt të drejteperdrejte në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit pranë Institucionit.
- Rritja e nivelit të shërbimit të auditimit duke synuar kompetence të lartë, objektivitet maksimal dhe standarte të larta etike.
- Rritja e aftësive profesionale dhe përmirësimi i njohurive baze të audituesve të brendshëm, në funksion të përmbushjes së misionit të tij si mbështetës dhe këshillues i pavarur për drejtimin e Institucionit, sepse produktet e tyre do rrisin vlerën e organizatës.
- Përmirësimi i cilesise së rekomandimeve, duke ofruar rekomandime efektive, të pershtatshme, të zbatueshme dhe të rrisë dobine të tyre për njesinë e audituar.
- Hartimi i Raporteve të auditimit konçiz, të sakta, bazuar në fakte dhe të vlefshme në ndihmë të menaxhimit për përmirësimin e punës dhe rritjen e efijënses së operacioneve financiare dhe të drejtimit.
- Ritja e cilesise së raportimit duke respektuar standartet në fushën e raportimit lidhur me cilesinë, qartësinë dhe dobishmerinë.
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të auditeve përmes trajnimeve në fushën e procedurave dhe metodave/teknikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut.

DREJTUESI I NJËSISË SË AB

Stefan KALULLI

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË DROPULL

Pasqyra 1

Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen nga Nj A B

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
I	Bashkia Dropull				
1	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.		X	
2	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	X		
3	Drejtoria e te Ardhurave	Vleresimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore		X	
4	Drejtoria e Administrimit te Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave	Vleresimi i sistemit mbi administrimin e ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave.		X	
5	Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve mbeshtetese	Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese.		X	
6	Drejtoria e Sherbimit Urban dhe Sherbimeve Publike	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.		X	
7	Njesia e Policise Bashkiake	Vleresimi i funksionimit te Policise Bashkiake.		X	
8	Njesia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	Vleresimi mbi funksionimin e Njesise se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit.		X	
9	Njesite Administrative	Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.		X	

10	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura			X
11	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.			
12	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.			
II	Bashkia Libohove				
1	Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.			
2	Sektori Juridik	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	X		
3	Sektori i Tatim taksave	Vleresimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore			
4	Sektori i Sherbimeve Bujqesore, Veterinare e Mjedisore	Vleresimi i sistemit mbi administrimin e ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave.	X		
5	Sektori i Burimeve Njerezore	Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese.			
6	Sektori i Sherbimit Urban	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.			
7	Njesia e Policise Bashkiake	Vleresimi i funksionimit te Policise Bashkiake.			
8	Njesia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	Vleresimi mbi funksionimin e Njesise se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit.			
9	Njesite Administrative	Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.			

10	Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura			X
11	Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	X		
III	Bashkia Finiq				
1	Drejtoria e Finances	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.		X	
2	Drejtoria Juridike	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	X		
3	Drejtoria e te Ardhurave	Vleresimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore		X	
4	Drejtoria e Bujqesise dhe Ujitjes e Kullimit. Si dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave	Vleresimi i sistemit mbi administrimin e tokave, ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave.	X		
5	Drejtoria e Burimeve Njerezore	Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese.			X
6	Drejtoria e Sherbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.			X
7	Njesia e Policise Bashkiake	Vleresimi i funksionimit te Policise Bashkiake.			X
8	Njesia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	Vleresimi mbi funksionimin e Njesise se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit.			X
9	Njesite Administrative	Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.			X
10	Drejtoria e Finances	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura			X

11	Drejtoria e Finances	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	X		
		Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.		X	
12	Drejtoria Juridike				

Drejtuessi i NJAB

Stefan KALULLI

Plani strategjik i subjekteve për tu audituar sipas viteve 2024 - 2026

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE

Nr	Viti planifikuar 2024	Niveli i Riskut (V.)	Viti I planif+1 2025	Niveli i Riskut (V.)	Viti I planif+2 2026	Niveli i Riskut (V.)
a.	1	2	3	4	5	6
I	Bashkia Dropull		Bashkia Dropull		Bashkia Dropull	
1	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.	I mesem			sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.	I mesem
2	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	I larte			Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	I larte
3			Vleresimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore	I mesem		
4			Vleresimi i sistemit mbi administrimin e ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave.	I mesem		
5	Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese.	I mesem			Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese.	I mesem
6	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	I mesem	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	I mesem	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	I mesem
7						

8	Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.	Vleresimi mbi funksionimin e Njesise se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit.	I mesem	Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.	I mesem
9	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I mesem	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I ulet
10	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I ulet	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I mesem
11	Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.		I mesem	Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.	I mesem
12				Bashkia Libohove	
II	Bashkia Libohove	Bashkia Libohove			
1	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.		I mesem	sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.	I mesem
2	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.		I larte	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	I larte
3		Vleresimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore	I mesem		
4		Vleresimi i sistemit mbi administrimin e ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave.	I larte		

	Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshetese.	I mesem			Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshetese.	I mesem
5	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	I mesem	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	I mesem	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	I mesem
6			Vleresimi i funksionimit te Policise Bashkiake.	I mesem		
7			Vleresimi mbi funksionimin e Njesise se mbrojtes nga zjarri dhe shpetimit.	I mesem		
8						
9	Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.	I mesem			Vleresimi i funksionimit te Njesive administrative.	I mesem
10	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I mesem	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I mesem	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I mesem
11	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I larte	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I larte	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I larte
III	Bashkia Finiq		Bashkia Finiq		Bashkia Finiq	
	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.	I mesem			sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare e Bashkise.	I mesem
	Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	I larte			Vleresim sistemi mbi prokurimet publike.	I larte
			Vleresimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore	I mesem		

		Vleresimi i sistemit mbi administrimin e tokave, ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave.	I larte		
	Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve dhe sherbimeve mbeshtetese.	I mesem		Vleresimi i sistemit mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese.	I mesem
			I mesem	Vleresimi i sherbimit urban dhe sherbimeve publike.	
			I mesem	Vleresimi i funksionimit te Policise Bashkiake.	
			I mesem	Vleresimi mbi funksionimin e Njese se mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit.	
	Vleresimi i funksionimit te Njese administrative.	I mesem		Vleresimi i funksionimit te Njese administrative.	I mesem
	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I mesem	I mesem	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	I mesem
	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I larte	I larte	Vleresimi i statusit te zbatimit te rekomandimeve.	I larte
	Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.	I mesem		Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.	I mesem

Drejtuessi NJAB

Stefan KALULLI

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA DROPULL

Pasqyra 3

Plani i angazhimeve te NJAB per vitin 2024

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditimi Gjithsej	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulentëve	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4,1	4,2	4,3	4,4	4,5	4,6	5
I	Bashkia Dropull		4	4	0	0	0	0	0	3
	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale, Drejtoria e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese, Drejtoria e sherbimit urban, si dhe Njesite Administrative.	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare, mbi prokurimet publike, mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese, mbi sherbimin urban dhe sherbimet publike, si dhe funksionimi i Njesive Administrative.	1	1						3
	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	1	1						3

	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Zbatimi i rekomandimeve te lena ne auditimet e meparshme.	1	1							3
	Drejtoria e buxhetit, finances dhe mbrojtjes sociale	Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.	1	1							3
II	Bashkia Libohove		3	3	0	0	0	0	0	0	3
	Spektori i Zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, Spektori Juridik, Spektori i burimeve njerezore, Spektori i sherbimit urban, si dhe Njesite Administrative.	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare, mbi prokurimet publike, mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese, mbi sherbimin urban dhe sherbimet publike, si dhe funksionimi i Njesive Administrative.	1	1							3
	Spektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	1	1							3
	Spektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar	Zbatimi i rekomandimeve te lena ne auditimet e meparshme.	1	1							

III	Bashkia Finiq		4	4	0	0	0	0	0	0	3
	Drejtoria e finances, Drejtoria juridike, Drejtoria e burimeve njerezore, Drejtoria e sherbimeve utilitare komunitare dhe administrative, si dhe Njesite Administrative.	Vleresimi mbi funksionimin e sistemit ne hartimin, planifikimin e buxhetit, si dhe veprimtaria financiare, mbi prokurimet publike, mbi menaxhimin e burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese, mbi sherbimin urban dhe sherbimet publike, si dhe funksionimi i Njesive Administrative.	1	1							3
	Drejtoria e finances	Vleresimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura	1	1							3
	Drejtoria e finances	Zbatimi i rekomandimeve te lena ne auditimet e meparshme.	1	1							3
	Drejtoria juridike	Vleresimi i pershtatshmerise dhe efektivitetit te sistemeve dhe operacioneve te menaxhimit te brendshem te fondeve IPA.	1	1							3
	SHUMA		11	11	0	0	0	0	0	0	3

Drejtuesi i NJAB

Stefan KALULLI



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË DROPULL

Pasqyra 4

Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2024

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarrës në trajnim (nr. personave)	Periodha (gjatë vitit)	Kohezgjatja e trajnimit (në ditë)
a.	1	2	3	4
1	Auditimi i performances. Qellimi dhe perfiltimi nga Auditimi i Performances. Planifikimi, metodologjia e përdorur për Auditimin e Performances dhe kryerja e këtij Auditimi. Si matet Performanca e subjekteve.	3	gjatë vitit	2 - 3 dite
2	Menaxhimi i Riskut. Procesi i menaxhimit të riskut, metodat, teknikat dhe hapat konkrete të ndjekura në praktike për identifikimin, vlerësimin, monitorimin, raportimin dhe menaxhimin e risqeve.	3	gjatë vitit	2 - 3 dite
3	Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm të fondeve IPA.	3	gjatë vitit	2-3 dite
	SHUMA			

Drejtuesi i NJAB
Stefan KALULLI



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINË DROPULL

Pasqyra 5

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2024

000/leke

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA			Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përllogaritja e burimeve		Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2	3		1	2
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52 jave x 5 dite x 3punonjës	1	Buxheti Gjithsej	3.431
2	Pushime Vjetore	60	4 jave/pers x 5 dite x 3punonj	2	Paga dhe Sig.Shoqërore	3.191
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	39	13 dite/ person x 3 persona	3	Shpenzime Udhëtimi & Diet	150
4	Pushime për arsye shëndetësore	15	5 dite/pers x 3 persona	4	Të tjera	90
5	Angazhime në trajnime	30	10 dite/pers x 3 pers	5	Numri i Punonjësve	3
6	Angazhime në mbledhje/takime	30	10 dite /person x 3 persona	6	Kosto për Person (1/5)	1.143
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	30	10 dite/ person x 3 persona			
	TOTALI	576 dite	192 dite/ person			

Drejtuesi i NJAB

Stefan KALULLI

